

FJALIM I DREJTORESHËS SË DREJTORISË SË DOGANAVE ME RASTIN E 26 JANARIT - DITA NDËRKOMBËTARE E DOGANAVE

Më 26 janar, të cilën Unioni Doganor e feston si Dita ndërkombëtare e doganave, ne kujtohem për rëndësinë e saj dhe i bëjmë nderim nëpunësve doganor dhe agjencive doganore për funksionimin dhe shqetësimin e tyre rreth qarkullimit të mallrave përtej kufijve në mbarë botën.

Në këtë ditë në vitin 1953, u mbajt mbledhja e parë e Këshillit për Bashkëpunim Doganor nën të cilin emër zyrtar udhëheqet Organizata Botërore e Doganave, e themeluar në vitin 1952 si një organ i pavarur ndërqeveritar me një mision specifik për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e administratave doganore.

Sot, në Organizatën Botërore të Doganave marrin pjesë 183 administrata doganore nga e gjithë bota, puna e të cilave mbulon rreth 98% të tregtisë botërore. Si qendër globale e ekspertizës botërore, Organizata Botërore e Doganave është e vetmja organizatë ndërkombëtare me kompetenca në çështjet doganore dhe me të drejtë vepron në emër të komunitetit ndërkombëtar doganor.

Sipas Planit Strategjik të miratuar 2019-2022, dhjetë prioritete mbeten si fusha më të rëndësishme për veprim të përbashkët: Plani akcionar për COVID-19, Menaxhimi i koordinuar i kufirit, Mbrojtja dhe siguria, Konventa e reviduar e Kiotos, Tregtia elektronike, Sistemi i harmonizuar, Strategjia e ndërtimit të kapacitetit, matja e efikasitetit, integriteti, dogana digjitale dhe analitika e të dhënave.

Si çdo vit, administratat doganore në mbarë botën përmes aktiviteteve të veçanta të organizuara festojnë 26 janarin, Ditën ndërkombëtare të doganave. Këtë vit kjo ditë do të shënohet me moton “Rritja e transformimit digjital doganor nëpërmjet pranimit të kulturës së të dhënave dhe ndërtimit të një ekosistemi të të dhënave”. Edhe pse ende po punohet në kushte të pandemisë e shkaktuar nga COVID-19, Dogana duhet të merret me sfidat përmes përdorimit të duhur të resurseve njerëzore dhe të dhënave të disponueshme.

Transformimi digjital i shoqërisë është trend global i bazuar në menaxhimin e të dhënave dhe në këtë drejtim Dogana është e fokusuar në disa tema në kuadër të kompetencave të saj. Dogana është pjesë e ekosistemit ekzistues së të dhënave (përcaktuar si grup i infrastrukturës, analitikës dhe aplikacioneve të cilat përdoren për regjistrimin dhe analizimin e të dhënave) aktorët e së cilës janë qytetarët, agjencitë qeveritare dhe kompanitë lokale dhe transnacionale, ndër të tjera, dhe të gjitha këto subjekte prodhojnë ose mbledhin një sasi të madhe të dhënash.

Të dhënat përdoren për të ndërtuar strategji, përmirësimin e cilësinë e luftës kundër mashtrimit dhe pagesën e të ardhurave, optimizimin e shpërndarjes së resurseve në terren dhe matjen e performancës së njërive organizative doganore. Me qëllim të menaxhimit dhe udhëheqjes së drejtë me shërbimet doganore, si dhe për të marrë vendimet e duhura,

posaçërisht duhet të merret parasysh se me të dhënat duhet të menaxhohet formalisht për të garantuar rëndësinë, saktësinë, dhe afatin kohor, dhe pas kësaj të përdoren standarde dhe qasje progresive. Është e një rëndësie të veçantë nxitja e kulturës së të dhënave, si dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit dhe ndërtimi i aftësive të tyre për të kuptuar dhe analizuar të dhënat, duke përdorur teknologjitë përkatëse me qasje dhe menaxhim etik.

Shkëmbimi i analizave të të dhënave me agjencitë e tjera qeveritare, opinionin e gjerë dhe akademinë, organizatat ndërkombëtare si dhe me shërbimet e tjera doganore rrit rolin dhe transparencën e Doganës në politikëbërjen, marrjen e resurseve të nevojshme si dhe financimin e donatorëve. Sekretariati i OBD-së ofron mbështetje për administratat doganore përmes komiteteve dhe grupeve të punës, seminare për rritjen e ndërgjegjjes, moduleve të mësimin elektronik që synojnë zhvillimin e metodologjive për analiza dhe shkëmbimin e të dhënave. Në këtë drejtim, Drejtoria e doganave e Republikës së Maqedonisë së Veriut i kushton vëmendje të veçantë mbledhjes dhe analizës së të dhënave relevante, menaxhimit të drejtë me informacionet e fituara dhe marrjen e vendimeve.

Drejtorja e doganave po bën përpjekje të veçanta për realizimin e projekteve në vitet e kaluara që nënkuptojnë transformim digjital dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve ndërmjet shërbimeve në vend si dhe me shërbimet e tjera doganore:

- Sistemi i ri me një ndalesë (NSW);
- Përditësimet e vazhdueshme të SPDDDA-s;
- Sistemi elektronik i shkëmbimit të të dhënave SEED + me vendet e CEFTA-s
- Sistemi i ri i kompjuterizuar i tranzitit - faza 5, si dhe projekte dhe aktivitete të tjera.

Prandaj, duke u nisur nga të gjitha përpjekjet që u bënë gjatë këtij viti jashtëzakonisht të vështirë janë ndërmarë nga më shumë subjekte juridike që plotësuan nevojat e Doganës, Drejtoria e doganave vendosi këtë vit certifikatat e Organizatës Botërore të Doganave për merita të veçanta, nën moton "Rritja e transformimit digjital doganor duke pranuar një kulturë të dhënash dhe duke ndërtuar një ekosistem të dhënash" t'ua shpërndajë institucioneve dhe organizatave, të cilat me aktivitetet e tyre janë dalluar si të merituar në krijimin e një mjedis biznesi të qëndrueshëm dhe konstruktiv dhe gjetjen e zgjidhjeve për përballimin me krizën të shkaktuar nga pandemia KOVID 19.

Drejtorja doganore do të vazhdojë të ndjek trendet moderne të zhvillimit dhe në frymën e teknologjisë inovative do të përpiqet të jetë në hap me të arriturat moderne, pa u ndalur në rrugën e tregtisë, duke mundësuar rritje të pandërprerë edhe në rrethana të vështira, duke ndjekur udhëzimet e OBD-së dhe duke aplikuar praktikat më të mira në fushën e tyre.

Me respekt,

Slavica Kutirov

Drejtor